



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 7

Prishtinë më, 24.03.2015 duke filluar në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit sala N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje murrën pjesë : Agim Qeku, nënkryetar i parë, Mufera Sinik, nënkryetare e dytë, Agim Kukaj, Fisnik Ismajli, Qerim Bajrami, Veton Berisha i Danush Ademi, anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, kryetarë, Jasmina Živković, Slavko Simiq i Milka Vuletiq, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë : vëzhgues të OSBE-së, OJ „Iniciativa e Graqanicës për Zhvillim të Qëndrueshëm, KDI, përfaqësuesi i ambasadës zvicerane.

Stafi për mbështetjen e komisionit: koordinator i Komisionit - Natasa Prica-Tishma.

Mbledhjen e kryesoi: Agim Qeku, nënkryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua dhe u miratua ky:

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve liria e lëvizjes u është kufizuar me vendim të gjyqit apo panelit për lirim me**

kusht, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitet, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencionit kundër korrupsionit;

- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 o për pengimin e konfliktit të interesit në kryerjen e funksioneve publike me amendamentet e Komisionit funksional për legjislacion, mandate, imunitete Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencionit kundër korrupsionit ;**
- 6. Të ndryshme.**

- 1. Zëvendëskryesuesi** – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa vërejtje dhe e hapi për shqyrtim pikën e dytë të rendit të ditës.

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

Zëvendëskryesuesi, konstatoi se i njëjti miratohet me vërejtjen e Veton Berishës dhe ngarkohet shërbimi i sekretariatit që të bëjë përmirësimet në pajtim me vërejtjen e dhënë.

Zëvendëskryesuesi - e hapi për shqyrtim pikën e tretë të rendit të ditës.

- 3. Shqyrtimi i projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Zëvendëskryesuesi – i njoftoi anëtarët e Komisionit që janë pjekur kushtet për mbajtjen e mbledhjes së Komisionit pasi që marrin pjesë shumica e kualifikuar për marrjen e vendimeve dhe në vazhdim i paraqiti disa vërejtje hyrëse dhe sqarime lidhur me Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ndërmarrjet publike duke theksuar se Komisioni funksional në detaje e ka shqyrtuar Projektligjin, si dhe është përgjegjës dhe Komisioni raportues ka përgatitur raportin me amendamentet të cilin Komisioni duhet ta shqyrtoj nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Meqë nuk kishte ndonjë vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara dhe pas shqyrtimit të secilit amendament dhe votimit sipas radhës, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Projektligji 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike me amendamentet e Komisionit funksional nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe njëkohësisht i propozon Kuvendit që i njëjti të aprovohet në leximin e dytë.**

Nënkryetari e hapi për shqyrtim pikën e katërt të rendit të ditës.

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 5/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve liria e lëvizjes u është kufizuar me vendim të gjyqit apo panelit për lirim me kusht, me amendamentet e Komisionit funksional për legjislacion, mandate, imunitet rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e agjencionit kundër korrupsionit.**

Me që nuk kishte vërejtje as diskutime për Projektligj dhe raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara dhe pas shqyrtimit të secilit amendament dhe votimit sipas radhës, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Projektligjit nr. 5/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes me vendim të gjyqit ose panelit për lirim me kusht, me amendamentet e propozuara të Komisionit funksional nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i propozon Kuvendit që të njëjtin ta miratoj në leximin e dytë.**

Nënkryetari e hapi për shqyrtim pikën e pestë të rendit të ditës.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 o për pengimin e konfliktit të interesit në kryerjen e funksioneve publike me amendamentet e Komisionit funksional për legjislacion, mandate, imunitete Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencionit kundër korrupsionit**

Me që nuk kishte vërejtje as diskutime në Projektligj dhe Raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara dhe pas shqyrtimit të secilit amendament dhe votimit sipas radhës, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 o për pengimin e konfliktit të interesit në kryerjen e funksioneve publike me amendamentet e Komisionit funksional nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve andaj i propozon Kuvendit që të njëjtin t'a miratojë në leximin e dytë.

Kryetari e hapi për shqyrtim pikën e 6 të rendit të ditës.

3. Të ndryshme

Danush Ademi – do të potencojë çështjen lidhur me skemën e ndihmës speciale për kujdesin e familjeve të rrezikuara në pajtim me kriteret e parapara me Ligjin në fuqi për skemat dhe ndihmat sociale. Ministria për punë dhe mirëqenie sociale i ka caktuar qendrat për udhëheqjen e skemave të ndihmës sociale dhe ata i nxjerrin dispozitat për udhëheqjen e drejtpërdrejtë me atë skemë. Andaj propozojë që ta ftojë ministrin z. Arban Abrashi të raportojë dhe të japë sqarimet e duhura dhe informatat lidhur me veprimet e dhënies së asistencës sociale me qëllim

të zgjidhjes së shumë kërkesave të qytetarëve, të cilët gjenden në një situatë tejet të vështirë , nga radhët e pjesëtarëve të Komunitetit të cilët unë i përfaqësojë në Komision, sepse këtë rol e kanë të gjitha organet e pushtetit me qëllim të shqyrtimit të çështjeve të cilët u përkasin komuniteteve.

Qerim Bajrami – do të shprehë pakënaqësinë time lidhur me pjesëmarrjen e pjesëtarëve tjerë të komuniteteve jo shumicë, përveç pjesëtarëve të komunitetit Serb, në strukturën e ardhshme të gjykatëseve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë të Kosovës. Shtrohet pyetja se çka po ndodhë me komunitetet tjera të cilat do të duhej të integrohen në sistemin gjyqësor të Kosovës? Për ne këto janë çështje shumë të rëndësishme dhe me siguri do të ndërmarrin diç në kuptim të respektimit të qëndrimeve dhe kërkesave tona.

Pyetja e dytë, ka të bëjë me aktivitetet e komisionit lidhur me mbikëqyrjen e ligjeve në institucionet e sistemit sipas planit të punës. Në këtë kontest, ne do të duhej të formonim grupe të punës për mbikëqyrjen e ligjeve, por ende asgjë nuk është ndërmarrë për formimin e tyre e që do të reflektohet në realizimin e objektivave të planit të punës dhe të zbatimit të qëllimeve programore.

Veton Berisha – kur është fjala për këso çështje të rëndësishme e përkrahë mendimin e Qerimit sepse ato kanë të bëjnë me vështirësitë kryesore me të cilat momentalisht po përballemi dhe duhet të angazhohemi që këto probleme të zgjidhen dhe në kuptim të formimit të grupeve të punës dhe çështjeve të tjera të cilat lidhen me funksionimin e komisionit në mënyrë operative në kryerjen e detyrave të parashtruara.

Zëvendëskryesuesi – keni të drejtë se situata është e tillë dh pajtohem me këtë. Mirëpo grupet e punës nuk janë formuar për shkak të mospjesëmarrjes së deputetëve nga radhët e komunitetit serb në punën e komisionit dhe në Kuvend në përgjithësi. Situata është e tillë që struktura e grupeve të punës duhet të reflektojë strukturën e të gjithë përfaqësuesve të komuniteteve të cilët marrin pjesë në komision, andaj për këto shkaqe nuk do t’ia fillojë me formimin e këtyre deri sa të krijohen këto kushte. Atë që Komisioni mund ta bëjë është që të vazhdojë të punojë në çështjet nga fusha e vetë të cilat lidhen me përgjegjësitë e sajë si dhe t’i zbatojë dhe t’i përmbahet procedurave të parapara.

Mbledhja përfundoi në 12:30

Njësia për komisione parlamentare

Nënkryetari i parë i Komisionit

Agim Çeku

